



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2019

PËR

**PËRJASHTIMIN NGA EMËRIMI, ZGJEDHJA NË ORGANE DREJTUESE DHE PUNËSIMIT
NË FUNKSIONE PUBLIKE, SHTETËRORE DHE POLITIKE TË ISH-FUNKSIONARËVE,
NËPUNËSVE QË KANË USHTRUAR DETYRA DREJTUESE NË PERIUDHËN 28.11.1944 E
DERI NË 8.12.1990.**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një grupi
deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton dhe rregullon masat që duhen ndërmarrë për çrrënjosjen e trashëgimisë së
sistemit totalitar komunist, të krimeve të komunizmit në Republikën e Shqipërisë të cilët nuk u
ndëshkuan dhe dënuan, duke përjashtuar nga emërimi, zgjedhja në organet drejtuese dhe
punësimi në funksionet publike, shtetërore dhe politike ish-funksionarët, nëpunësit që kanë
ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.1944 - 08.12.1990.

Neni 2

Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për të gjithë ish – funksionarët, nëpunësit që kanë ushtruar detyra drejtuese në
periudhën 28.11.1944 – 08.12.1990, me shtetësi shqiptare dhe që ndodhen brenda territorit të
Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Përfshirja nga emërimi në funksione publike, shtetërore dhe politike

1. Përfshihen nga emërimi në funksione publike, shtetërore dhe politike ish- funksionarët, nëpunësit që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.1944 - 08.12.1990 si:
 - Anëtarë të Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH) dhe të Partisë Punës së Shqipërisë;
 - Ish - funksionarët e Sistemit Komunist;
 - Ish- gjyqtarë, ish-prokurorë, ish-hetues, ish-Oficerë të Sigurimit të Shtetit Komunist, dhe ish- bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit (Spiunë Sigurimi);
 - Të shkolluarit dhe të kualifikuarit në shkollat e larta politike të Partisë Punës së Shqipërisë (PPSH-së) dhe të Sigurimit të Shtetit të Mbrojtjes në ish-vendet e traktatit të Varshavës;
 - Ish-anëtarët ose bashkëpunëtorët e Shërbimeve të Inteligjencës së ish-vendeve të Traktatit të Varshavës.
2. Ish-funksionarët, nëpunësit që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.2019- 08.12.1990 nuk mund të emërohen në funksione publike, shtetërore dhe politike si:
 - President i Republikës së Shqipërisë;
 - Kryeministër i Republikës së Shqipërisë;
 - Deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
 - Ministër i Republikës së Shqipërisë;
 - Zv. Ministër i Republikës së Shqipërisë;
 - Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese;
 - Anëtarë të Gjykatës së Lartë;
 - Anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED);
 - Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ);
 - Anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP);
 - Titullarë të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese që zgjidhen ose emërohen nga Kuvendi, Presidenti, Kryeministri, Këshilli i Ministrave;
 - Prokurorë ose Gjyqtarë të të gjitha niveleve;
 - Kryetar Bashkie;
 - Prefekt;
 - Drejtorë të Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie, Drejtorë Rajonalë në të gjitha institucionet shtetërore;
 - Drejtorë dhe Drejtues në Policinë e Shtetit;
 - Të Shërbimit Informativ të Shtetit;
 - Të Gardës së Republikës së Shqipërisë;
 - Të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë;
 - Ambasador;

- Konsull;
- Sekretarë të Përgjithshëm në çdo institucion;
- Këshilltarë dhe shefë kabineti të Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, Ministrave, të Institucioneve Kushtetuese;

Neni 4

Përfshirja nga zgjedhja në organe drejtuese publike, shtetërore dhe politike

1. Përfshihen nga zgjedhja në organe drejtuese publike, shtetërore dhe politike ish-funksionarët, nëpunësit që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.2019-08.12.1990 si:
 - Anëtarë të Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH) dhe të Partisë Punës së Shqipërisë;
 - Ish - funksionarët e Sistemit Komunist;
 - Ish- gjyqtarë, ish-prokurorë, ish-hetues, ish-Oficerë të Sigurimit të Shtetit Komunist, dhe ish- bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit (Spiunë Sigurimi);
 - Të shkolluarit dhe të kualifikuarit në shkollat e larta politike të Partisë Punës së Shqipërisë (PPSH-së) dhe të Sigurimit të Shtetit të Mbrojtjes në ish-vendet e traktatit të Varshavës;
 - Ish-anëtarët ose bashkëpunëtorët e Shërbimeve të Inteligjencës së ish-vendeve të Traktatit të Varshavës.

2. Ish-funksionarët, nëpunësit që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.2019-08.12.1990 nuk mund të zgjidhen në organe drejtuese publike, shtetërore dhe politike si:
 - President i Republikës së Shqipërisë;
 - Kryeministër i Republikës së Shqipërisë;
 - Deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
 - Ministër i Republikës së Shqipërisë;
 - Zv. Ministër i Republikës së Shqipërisë;
 - Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese;
 - Anëtarë të Gjykatës së Lartë;
 - Anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED);
 - Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ);
 - Anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP);
 - Titullarë të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese që zgjidhen ose emërohen nga Kuvendi, Presidenti, Kryeministri, Këshilli i Ministrave;
 - Prokurorë ose Gjyqtarë të të gjitha niveleve;
 - Kryetar Bashkie;
 - Prefekt;

- Drejtorë të Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie, Drejtorë Rajonalë në të gjitha institucionet shtetërore;
- Drejtorë dhe Drejtues në Policinë e Shtetit;
- Të Shërbimit Informativ të Shtetit;
- Të Gardës së Republikës së Shqipërisë;
- Të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë;
- Ambasador;
- Konsull;
- Sekretarë të Përgjithshëm në çdo institucion;
- Këshilltarë dhe shefë kabineti të Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, Ministrave, të Institucioneve Kushtetuese;

Neni 5

Përfshirja nga punësimi në funksione publike, shtetërore dhe politike

1. Përfshihen nga punësimi në funksione publike, shtetërore dhe politike ish-funksionarët, nëpunësit që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.2019-08.12.1990 si:
 - Anëtarë të Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH) dhe të Partisë Punës së Shqipërisë;
 - Ish - funksionarët e Sistemit Komunist;
 - Ish- gjyqtarë, ish-prokurorë, ish-hetues, ish-Oficerë të Sigurimit të Shtetit Komunist, dhe ish- bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit (Spiunë Sigurimi);
 - Të shkolluarit dhe të kualifikuarit në shkollat e larta politike të Partisë Punës së Shqipërisë (PPSH-së) dhe të Sigurimit të Shtetit të Mbrojtjes në ish-vendet e traktatit të Varshavës;
 - Ish-anëtarët ose bashkëpunëtorët e Shërbimeve të Inteligjencës së ish-vendeve të Traktatit të Varshavës.
2. Ish-funksionarët, nëpunësit që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.2019-08.12.1990 nuk mund të punësohen në funksione publike, shtetërore dhe politike:
 - Në kabinetin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
 - Në kabinetin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë;
 - Në kabinetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
 - Në kabinetin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë;
 - Në kabinetin dhe personelin e punësuar të Gjykatës Kushtetuese;
 - Në kabinetin dhe personelin e punësuar të Gjykatës së Lartë;
 - Në kabinetin dhe personelin e punësuar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED);
 - Në kabinetin dhe personelin e punësuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ);
 - Në kabinetin dhe personelin e punësuar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP);

- Në kabinetin dhe personelin e punësuar të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese që zgjidhen ose emërohen nga Kuvendi, Presidenti, Kryeministri, Këshilli i Ministrave;
- Si sekretarë, këshilltarë dhe nëpunës gjyqësor të Prokurorëve ose Gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- Në kabinetin dhe personelin e punësuar të çdo Bashkie;
- Në kabinetin dhe personelin e punësuar të çdo Prefekturë;
- Në kabinetin dhe personelin e punësuar të çdo Drejtorie të Përgjithshme, Drejtorie Rajonale në të gjitha institucionet shtetërore;
- Në kabinetin dhe personelin e punësuar të Drejtorisë në Policinë e Shtetit;
- Në kabinetin dhe personelin e punësuar të Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH);
- Në kabinetin dhe personelin e punësuar në Gardën e Republikës së Shqipërisë;
- Në kabinetin dhe personelin e punësuar në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë;
- Në kabinetin dhe personelin e punësuar të çdo Ambasadë Shqiptare;
- Në kabinetin dhe personelin e punësuar të çdo Konsullatë Shqiptare;
- Në kabinetin dhe personelin e çdo Sekretarie të Përgjithshme të çdo institucioni;

Neni 6

Për të gjithë funksionarët e zgjedhur nga vota e shtetasve shqiptarë, ky ligj është i zbatueshëm në zgjedhjet e para më të afërta, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI

D. G. Parlamentit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

Lënda:

Propozim për Projektligj

Drejtuar:

**Z. Gramoz Ruçi
KRYETAR I KUVENDIT**

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës, dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, një grup deputetësh të Opozitës Parlamentare, depozitojnë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend nismën ligjore: “ Për Përfundimin nga emërimi, zgjedhja në organe drejtuese dhe të punësimit në funksione publike, shtetërore dhe politike të ish – funksionarëve, nëpunësve që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.1944 -08.12.1990”.

Bashkëlidhur janë teksti i nismës dhe relacioni shoqërues i tij.

DEPUTETËT PROPOZUES

Myslim Muma

DEPUTETËT PROPOZUES:

Halit Valtteri

Myslim Minhas

RAF GJONI

Artind Çaçani

Ismael Rryçi

Hajrinda Halilaj

Azla'ehke Alimseini

Zef Juferru

Elda Hoti

Edlira Hysemi

ARTUR ROSHI

BESNIK TROPZINI

Wahelisa Jula

Vasil Sterjovski

HALIL DAKIMI

Arben Elazi

LIBORAQ KARAMELO

Rudina Hajolani

Konob Riti

Jajane Dimitre